

Grimca Krishtlindje (pjesa 5 nga 5)

Grimca Paqeje

Përshëndetje miq, si po i kaloni këto ditë të fundit të këtij viti? Dua të ndaj mesazhin e fundit për këtë vit, dhe është nga seria Grimca Krishtlindjeje. Mesazhi sot është Grimca Shprese. Uroj që ky mesazh të shtojë shpresën në ty sot.

A e dini se çfarë kanë të përbashkët Maria, Jozefi dhe barinjët? Engjëlli u tha të treve: "**Mos kini frikë.**" A nuk ju duket interesante? Sepse në fakt të tre patën frikë.

A e ke parë ndonjëherë programin Fear Factor, ku konkurrentët duhet të hanë insekte ose të futen nëpër vende të ngushta, apo të bëjnë lloj çmendurish? Jam shumë kurioz, kush i ka qejf këto gjëra. Dhe kush do të donte të bënte një gjë të tillë. E zëmë se je ftuar në këtë program dhe fiton 10 mijë euro po i bërë të gjitha ato gjërat e frikshme. Kush do të shkonte?

Frikërat mund të jenë të ndryshme. Mund të jenë në lidhje me punën, shkollën, marrëdhëniet, fëmijët, familjen, shëndetin, financat...

Jeta është plot me frikëra. Maria kishte frikë kur mori vesh lajmin se është zgjedhur ajo që të lindë Jezusin. Ishte fëmija i parë dhe do të ketë menduar: çfarë do të ndodhë me mua? Si do të ndodhë kjo gjë?

Jozefi gjithashtu kishte frikë: çfarë do të thotë bota kur ta marrë vesh që e fejuara ime është shtatzënë?

Barinjët patën frikë sepse befasi iu shfaqën engjëj nga qielli.

Luka 2:10 *'Por engjëlli u tha atyre: "Mos druani, sepse unë po ju lajmëroj një gëzim të madh për të gjithë popullin;'*

Dhe ata dhanë lajmin që do të lindë Shpëtimtari, që është Krishti, Zoti. Dhe iu dhanë detaje se si do ta dallonin se kush është fëmija. Pastaj engjëjt kënduan dhe ja si ishte kënga e tyre:

Luka 2:14 *"Lavdi Perëndisë në vendet më të larta, dhe paqe mbi tokë njerëzve mbi të cilët qëndron mirëdashja e Tij!"'*

Paqe mbi tokë, paqe mbi njerëzit,
mos kini frikë sepse Perëndia sjell paqen e Tij.

Do të lexojmë një pasazh nga Gjoni kap. 14 për atë që thotë për Paqen e

Perëndisë. Por së pari, të them se cili është konteksti. Jezusi po i bën me dije dishepujt e Tij se çfarë do të ndodhë shumë shpejt. Jezusin do ta marrin, do ta arrestojnë dhe do ta dënojnë me kryqëzim. Dhe iu tregon dishepujve: *ju do të shpërndaheni nga frika. Pjetri thotë, unë jo. Por Jezusi i thotë: madje, ti, Pjetër, do të më mohosh që më njeh mua.* Por Pjetri tha: *jo, kurrë.* Por Jezusi i tha: *në të vërtetë, do të më mohosh 3 herë që nuk më njeh para se të këndojë gjeli.* Ky është konteksti kur Jezusi fillon të flasë këtë që do të lexojmë në kap. 14.

Gjoni 14:1 *"Zemra juaj mos u trondittë; besoni në Perëndi dhe besoni edhe në mua!"*

Gjoni 14:2 *'Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa; përndryshe do t'ju thosha. Unë po shkoj t'ju përgatis një vend.'*

Gjoni 14:3 *'Dhe kur të shkoj e t'ju përgatis vendin, do të kthehem dhe do t'ju marr pranë meje, që aty ku jam unë, të jeni edhe ju.'*

Disa kapituj më poshtë, Jezusi vazhdon...

Gjoni 16:20 *'Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them: ju do të qani dhe do të mbani zi dhe bota do të gëzohet. Ju do të pikëlloheni, por pikëllimi juaj do të kthehet në gëzim.'*

Jezusi po thotë: "Me të vërtetë unë do të vdes në kryq dhe ju do të qani dhe do të mbani zi. Por pasi të vdes, kjo gjë do të kthehet për mirë. Pikëllimi do të kthehet në gëzim." Dhe tani thotë arsyen pse ua ka thënë këto gjëra:

Gjoni 16:33 *'Jua kam thënë këto gjëra, që ta keni paqen në mua; në botë do të keni mundime, por merrni zemër, unë e munda botën!'"'*

Ja çfarë tha pak më lart Jezusi...

Gjoni 16:25-27 *'Jua kam thënë këto gjëra në shëmbëlltyra, por po vjen ora kur nuk do t'ju flas më me shëmbëlltyra, por do t'ju flas haptas për Atin. Në atë ditë ju do të kërkoni në emrin tim; dhe nuk po them se unë do t'i lutem Atit për ju; Ati vetë në fakt ju do, sepse ju më deshët mua dhe keni besuar se unë dola nga Perëndia.'*

Grimca Pajeje është mesazhi sot. Është pjesa e pestë dhe e fundit e serisë *Grimca Krishtlindje*, dhe folëm për grimca Shprese, Dashurie, Gëzimi, Besimi. Uroj që do të kesh më shumë Paje në fund të këtij mesazhi.

Kam paqe kur i di si janë gjërat, dhe kur kam paqe kam guxim.

Jezusi ua dha faktet, detajet, kështu që ata mund ta dinin plotësisht se çfarë do të ndodhte dhe cili është hapi i radhës. Dhe kjo do t'u jepte paqe.

Mari, ti do të ngelesh shtatzënë edhe pse je e virgjër, kjo do të ndodhë nga Perëndia. Sigurisht që ajo ka frikë, por ama Ai po i jep detajet se si do të ndodhë kjo gjë.

Prandaj ka shumë frikë dhe tension në kohën e pandemisë, sepse ka shumë gjëra të paqarta. Paqartësia sjell frikë. Guximtar, pa frikë, bëhesh kur e di kush është Ati yt, kush është Perëndia yt, çfarë ka premtuar; kjo lloj dije e largon frikën dhe rrit paqen tënde.

Ju e njihni Atin, besojini Atij, (kapitulli 14), më besoni dhe Mua. Unë po shkoj të përgatis një vend te Ati. Ajo që dimë, të njohësh Atin, të jep siguri, të jep paqe.

Kaq thjesht është paqja, grimca të tilla të duhen që të jetosh një jetë në paqe. Ke faktet nga Fjala e Perëndisë dhe ti e njeh Atin. Kur i beson Perëndisë, ti merr dhuratën e Paqes nga Ai. Dhe Paqja e Tij prek të treja dimensionet e jetës: të shkuarën, të sotmen dhe të ardhmen. Së pari ke...

Paqe Për Të Shkuarën

Pjetri ishte ndjekës i përkushtuar ndaj Jezusit, por ama kur filloi presioni dhe u vu para sfidave, u dorëzua. Kur Jezusi u arrestua, një shërbëtoreshë e pyeti: "Më dukesh fytyrë e njohur, mos je një nga shokët e Jezusit ti?" "Jo, jo, jo, nuk jam, më ngatërron me dikë tjetër," - tha Pjetri. Dhe kjo ndodhi tre herë. Pjetri tri herë e mohoi Jezusin, e teproi një çikë, më duket.

A ke bërë ti ndonjë gafë, ndonjë gabim, mëkat, kur ti thoshe: "Unë kurrë s'do e bëj filan gjë," dhe pastaj çfarë ndodh, ti bën fiks atë gjë? Çfarë ndjenje ke pastaj? A të bezdis kjo gjë, duket sikur e urren veten? "Sa kot që u solla, si e thashë atë gjë, si e bëra atë gjë, si përfundova këtu, boo e pabesueshme."

Të gjithë bëjmë gabime herë pas here dhe kemi ndjenja të tilla faji të tilla. Por ama, me Pjetrin, pasi Jezusi u ringjall pas 3 ditësh, pasi vdiq në kryq, (shiko, kjo është histori më vete, por për këtë do flasim për Pashkë me detaje) ndër personat e parë që takon Jezusi është Pjetri. Jezusi do që ta qetësojë, ta shërojë dhe t'i kthejë paqen.

Prandaj e dërgoi Perëndia Birin e Tij që të kemi paqe me Të, të pajtohemi

me Të. Çfarë i tha Jezusi Pjetrit? "Unë dua që ti të kesh paqe me të shkuarën. Ajo iku. Por ama tani dua që ti..."

Të çohesh dhe të kesh guxim

Pjetri kishte qëndrimin që kemi edhe ne në kohë të tilla. Kur ti bën rrëmujë dhe e ke prishur muhabetin, nuk të bëhet të çohesh në këmbë, s'ke pikë fuqie. Por Jezusi erdhi te Pjetri që të bënte paqe me të shkuarën e tij. "Ndodhi, iku, mbaroi e shkuara, tani çohu dhe shkëlqe. Çohu dhe Unë do të të bëj peshkatar njerëzish. Ti do të ndikosh kaq shumë njerëz me jetën tënde, ti do jesh model për shumë. Kur ata të rrëzohen, të shikojnë ty si u çove ti, të çohen dhe ata."

Çohu, Shqipe, dhe Fluturo

Shqipet fluturojnë lart, janë bërë për të fluturuar lart, nuk mund t'i mbyllësh në kotec me pulat. Ajo që ndodhi, ndodhi. Kërko falje dhe lëre pas.

Ti mund të rrëzohesh, por ata që shpresojnë te Zoti, janë si çfarë? Si shqiponjat! Nëse ka njeri në botë që krenohet me shqiponjat, ata janë bijtë e Shqipërisë. Je ti.

Kur rrëzohet dikush ka tendencën të struket e të fshihet, jo të çohet e të fluturojë përsëri. Sepse frika e mban poshtë. Kurse ti çohu, pastrohu dhe fluturo lart, shkëlqe.

Ilustrim: Steve Jobs filloi kompaninë e tij Apple, që më vonë filloi edhe iPhone dhe shumë gjëra të tjera. Kishte 3 shokë dhe vendosën që fitimet do të ndaheshin 45% për Steve, 45% për partnerin tjetër, dhe 10% për shokun e tretë që ishte shumë ndihmë. Por Wayne, ky shoku i tretë, brenda një jave u tërhoq dhe tha: "Dua lekët e mia, se nuk besoj që kjo kompani do të ketë sukses. Ja sa probleme na ndodhën sot, nuk kam shpresë, kam frikë që do humb lekët e mia." Dhe ai mori pjesën e tij prej \$800 dhe iku në shtëpi shumë i lumtur. Prit pak, nëse nuk do të ishte tërhequr, 10% i tij sot do të ishte \$2.6 miliardë. U tërhoq shpejt, u dorëzua kollaj, sepse s'kishte shpresë.

Kthehemi te jetët tona, çfarë do të bësh, a do të tërhiqesh dhe do të strukesh apo do që të ndikosh me jetën tënde? A do të kapesh pas gjërave të vogla, hatërmbetje, qejfprishje, apo do ta investosh jetën tënde për të ndikuar në emër të Jezusit?

Perëndia na jep paqe për të shkuarën, duke na pastruar mëkatet tona të së shkuarës. Që të çohemi dhe të investojmë jetët tona dhe të sjellim ndryshim.

Sa nga ju jeni tërhequr në shtëpitë tuaja dhe nuk po bëni atë që duhet të bëjë lideri i familjes? Sepse keni frikë se ata e dinë se sa gabime keni bërë ju?

Ndoshta për ty si prind, nëse po e dëgjon këtë, dhe po pret një fjalë, mund të jetë: "Çohu dhe jepi drejtim familjes tënde. Ti je lideri i familjes tënde, ti mund ta sjellësh ndryshimin."

Ndoshta ti je tërhequr dhe s'po bën më gjërat që bëje dhe po të pëlqen rehatia, por e vërteta është se do të të çojë në përtaci dhe ndikimi yt do të zvogëlohet. Në vend të kësaj, çohu dhe jepi drejtim punës, shërbesës, skuadrës, grupit që drejton ti.

Në paqe me të shkuarën, së pari, të jep paqe kur e ke të shkuarën e pastruar, nga gjaku i Krishtit që u derdh për ty, të pajtoi me Perëndinë, e bëri zemrën më të bardhë se bora. Së dyti...

Paqe Për Të Ardhmen

Po shikoja një video me çunin tim. Videoja kishte shumë tension dhe ai po tensionohej se si do të përfundonte, kurse unë isha shumë i qetë. E di pse isha i qetë? Sepse e kisha parë më parë videon, e dija si do të përfundonte.

Shokë, Perëndia e ka parë videon e jetës tonë dhe Ai e di fundin. Dhe kjo duhet të na japë paqe, qetësi.

Këtë thotë Gjoni 14: Perëndia e di, e di kur do të jetë fundi i kësaj bote, e di kur ndodhin dhe pse ndodhin gjërat, asgjë nuk e habit Atë apo e zë në befasi. Sepse Ai e di fundin, e ka parë videon e kësaj bote.

Kurse për ne, ai e di se do të bëjë që të gjitha gjërat të bashkëveprojnë për mirë për ata që e duan atë. Madje Ai ka përgatitur një vend për ty në qiell. Prandaj Perëndia kërkon nga ne...

Të çohesh e të qetësohesh

Të bësh gjërat që duhen bërë, duke pasur këtë lloj qetësie dhe paqeje dhe sigurie për të ardhmen. Nëse ka ndonjë grup njerëzish që duhet të jetë i qetë, duhet të jemi ne. Sepse Perëndia e ka parë.

Si po e jeton jetën, sikur s'do vdesësh asnjëherë, apo kurdo që të vdesësh, ti ke sigurinë që do të jesh me Perëndinë? Kjo e dyta të jep paqe. Një nga muhabetet që njerëzit nuk kanë qejf të bëjnë është, kur vjen puna te vdekja. Duan ta shmangin me çdo kusht, ndërkohë njerëzit vdesin përditë, për shkak të moshës, sëmundjeve, viruseve, aksidenteve, shëndetit, etj. etj... Por, edhe

pse personi mund ta dijë me siguri që do të vdesë nga kjo sëmundje që ka pas ca muajsh, nuk do të flasë.

Ilustrim: Para disa ditësh isha me gruan time për darkë me një mikun tonë nga Hollanda. Një mik shumë i veçantë për ne. Gruaja e tij vdiq në korrik nga kanceri, çifti fantastik. Na kanë qëndruar afër, mua dhe gruas sime, në verën e vitit 2001. Ishin në dasmën e motrës time, kanë qenë aty kur lindi nipi im me sindromën Down, ndihmuan motrën time për të ardhur në kryeqytet. Ishin në dasmën tonë, na ndihmuan ne si çift i ri me sfidat tona. Shumë miq të veçantë për ne.

Dhe u trishtuam kur dëgjuam për vdekjen e gruas së tij. Por ai po thoshte se sa me qetësi e kishte pritur ajo vdekjen. Ajo vuante nga një sëmundje e keqe, dhe doktori i dha disa muaj jetë. Dhe të dëgjoje se si i kishte kaluar muajt e fundit të jetës, çfarë bisedash me burrin dhe fëmijët, një lloj paqeje totale. *Sigurisht, tha, që kishte lot, jemi lutur, kemi qarë dhe kemi qeshur, POR ishte shumë e qetë dhe e paqtë deri në ditën kur dha frymën.* Tamam si shenjtorë, që është plot me praninë e Perëndisë dhe nuk e frikëson asgjë.

Shokë, mos më keqkuptoni, nuk po promovoj vdekjen. Jetofshim të gjithë mbi 100 vjeç dhe shijofshim çdo ditë që do na japë Perëndia mbi tokë. Por t'i jetojmë me qetësinë, me paqe për të ardhmen.

A duket sikur stresi dhe frikërat po na dëmtojnë shumë, sidomos këto kohë? Dhe sillemi sikur Perëndisë i ka dalë nga duart situata?

Se shiko, kur ti ke bërë paqe me të shkuarën, për shkak të asaj që ka bërë Jezusi për ty dhe ke paqe me të ardhmen dhe sigurinë e të ardhmes, atëherë natyrshëm ti do të kesh....

Paqe me të sotmen

Do jesh i qetë në jetën e përditshme...

Gjoni 16:27 *'Ati vetë në fakt ju do, sepse ju më deshët mua dhe keni besuar se unë dola nga Perëndia.'*

Shiko çfarë vargjesh, lejoji të bien mbi ty si shi i butë.

Filipianëve 4:4-5 *'Gëzohuni gjithnjë në Zotin; po jua them përsëri: Gëzohuni! Zemërbutësia juaj le të njihet nga të gjithë njerëzit; Zoti është afër.'*

Filipianëve 4:6 *'Mos u shqetësoni për asgjë, por, në çdo gjë, ia parashtroni*

kërkesat tuaja Perëndisë me anë lutjesh dhe përgjërimesh, me falënderim.'

Mesazhi po vjen drejt fundit. E di si më duket ndonjëherë jeta? Si një reklamë e një birre: Kinemaja është e mbushur me burra motorristë, burra të mëdhenj, me xhaketa e jelekë lëkure, me tatuazhe, pircing, flokë të gjata dhe janë lënë vetëm 2 karrige bosh në mes. Dhe iu është bërë kamera e fshehtë, çifteve të pafajshëm, që shkojnë për të parë një film.

Sa e paparë është, por a nuk duket sikur kështu e shohim edhe ne jetën? Të mbushur me gogola, me probleme, me armiq, kundërshtarë, telashe...

Mos ki frikë, e shkuara jote është e pastruar, e ardhmja jote është e siguruar, jetoje të sotmen me paqe, me siguri. Gëzohu në Zotin!

Jeta ka plot pasiguri, por Perëndia është siguria jote. Varu te Perëndia, ditë pas dite, te premtimet e Tij, te Fjala e Tij. Dhe...

Filipianëve 4:7 *'Dhe paqja e Perëndisë, që ia tejkalon çdo zgjuarsie, do të ruajë zemrat tuaja dhe mendjet tuaja në Krishtin Jezus.'*

Le të lutemi.

Lutja e shpëtimit!